



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 qershor 2014
Nr.ref.:RK653/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI29/14

Parashtrues

Halit Islami

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 138/2013, të 11 korrikut 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Halit Islami (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Brainë, komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 138/2013, të 7 korrikut 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit më 12 shtator 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza ligjore

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI29/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI29/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 10 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë autorizimin për z. Ramiz Suka i cili përfaqëson atë në Gjykatë. Sidoqoftë Gjykata nuk ka marrë përgjigje deri më tani.
8. Më 10 mars 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe Qendrës së Studentëve të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë.
9. Më 12 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 8 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 27/10, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit për kthimin në punë në Qendrën e Studentëve të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Gjykata Komunale konstatoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës nuk ishte mjaft e qartë dhe, edhe pse Gjykata kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që ta përmirësojë dhe plotësojë ankesën, parashtruesi nuk kishte vepruar në mënyrë

të tillë. Prandaj, në pajtim me nenin 102.3 të Ligjit për procedurën kontestimore, Gjykata e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

11. Më 6 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 230/2012, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 8 nëntorit 2011. Gjykata e Qarkut konstatoi se *“Meqenëqë padia ka qen e paqartë, sepse në të nuk është përmendur vendimi se cili është qëllimi i anulimit të kërkesës, paditësit në dy raste i është kthyer padia nga ana e gjykatës së shkallës së parë në plotësim. Paditësi me parashtrësat e veta nuk e ka korrigjuar kërkesëpadinë, ashtu që gjykata e shkallës së parë kishte me vepruar në të. Gjithashtu me kërkesëpadinë paditësi nuk e ka pastruar se kush është i padituri në këtë kontest, se a është ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë apo Organi i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës. se kush e ka marr vendimin përfundimtar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Si që është padia e paqartë, nga ato nuk mund të vihet në përfundim se çka konkretisht paditësi propozon. Andaj, në mënyrë të drejtë gjykata e shkallës së parë konstatoi se padia e paditësit është e paqarte, dhe se paditësi me parashtrësat e veta nuk e ka korrigjuar padinë, për çka edhe ky e pranon se nuk ka vepruar sipas urdhëresave të gjykatës”*. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme ndaj këtij aktvendimi.
12. Më 11 korrik 2013, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 138/2013, e hodhi poshtë si të palejueshëm revizionin ndaj aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Gjykata Supreme gjeti se *“Sipas dispozitës se nenit 228.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimit të formës së prerë me të cilin përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë. Nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar ngase gjykata në këtë çështje ka hedhur padinë në kuptim të nenit 102.3 të LPK, dhe sipas nenit 228.1 të LPK, procedura në këtë çështje nuk ka përfunduar në formë të prerë”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se punëdhënësi ia ndërpreu atij marrëdhënien e punës, duke u bazuar në supozime të pavërteta dhe, me këtë, është shkelur neni 49 [e Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”.

16. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi, ose [...]”.

17. Vendimi përfundimtar i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 138/2013, është marrë më 7 korrik 2013 dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 12 shtator 2013, ndërsa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 11 shkurt 2014, që është më shumë se 4 (katër) muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar aktvendimi i Gjykatës Supreme.

18. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme, sepse është e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, rregullat 36 (1) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 12 maj 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani